




REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KUVENDI I KOMUNËS

01 Nr. 060/01-11638/2019

Datë. 28.03.2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tretë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2019, e mbajtur me datën 04.03.2019, me fillim në orën 10.00, në objektin e Komunës në Rr. "UÇK" në (ish objekti i BANKOS-it) **kati i -IV- Salla e Kuvendit të Komunës .**

Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Anton Shala .

Në mbledhje marrin pjesë 31 anëtarë të Kuvendit të Komunës: z. Haxhi Sejdiu, z. Nik Hyseni, z. Jusuf Osmani, z. Shaban Luma, znj. Teuta Pallaska-Milla, znj. Florentina Gjergjaj, znj. Albina Sadrija, z. Muharrem Musa, z. Basri Komoni, znj. Diana Qarkaxhija, znj. Hana Zeka, znj. Edi Puka, znj. Drita Buza-Zhaveli, z. Agon Batusha, znj. Mimoza Shala, znj. Lirika Komoni, z. Kreshnik Alijaj, z. Bekim Jupa, znj. Miranada Lushaj, znj. Dafina Sylja, z. Bashkim Gashaj, z. Sadik Hoti, znj. Saranda Hoda, z. Bekim Ermeni znj. Besarta Lekaj, z. Anton Shala, z. Zef Komani, znj. Arjeta Gjoklaj, z. Fazli Hoxha, znj. Valentina Alijaj, z. Edmond Dushi .

Mungojnë: z. Jeton Vorfi, me arsye dhe z. Shpend Kumnoa .

Të pranishëm të tjerë: Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, Nënkryetari i Komunës z. Ramadan Hoti, Drejtorët e Drejtorive Komunale, përfaqësues të ZKKK-së, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së, zyrtarët për informim, zyrtarë të tjerë Komunal, si dhe përfaqësues nga mediat e shkruara dhe elektronike dhe qytetarë dhe zyrtar të tjerë të Komunës së Gjakovës.

Kryesuesi: I nderuar Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, i nderuar Nënkryetari i Komunës z. Ramadan Hoti, të nderuar anëtarë të pranishëm të Kuvendit të Komunës, Drejtor të drejtorive Komunale, të nderuar përfaqësues të OSBE-së, të nderuar përfaqësues të Mediave, të nderur të Pranishëm .

Sot do ta kemi mbledhjen e tretë të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2019, Ju njoftoj se Kuvendi edhe për këtë mbledhje i ka 33 anëtarë, sepse ende nuk është bërë zëvendësimi nga KQZ -ja për dy anëtarët që janë tërhequr nga Kuvendi, në vitin 2018 Të pranishëm në këtë mbledhje janë: 30 anëtarë, z. Jeton Vorfi ka njoftuar se është në termin në Ambasadë dhe do të vonohet për mbledhje meqenëse kemi kuorumin po fillojmë me mbledhjen .

Rendin e ditës për këtë mbledhje e kemi marrë së bashku me ftesën dhe materialin e mbledhjes sipas afateve të përcaktuara ligjore, mirëpo e kemi edhe një kërkesë nga Kryetari që si pik të rendit të ditës për këtë mbledhje ta kemi edhe Nismën për bashkëpunim nder komunalë me komunën e Rahovecit andaj e ftoj Kryetarin e Komunës që ta merr fjalën .

Kryetari: Kjo ka të bëjë me grandin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për investime në infrastrukturë dhe në jemi dakorduar me kryetarin e Komunës së Rahovecit që në sot ta miratojmë këtë nismë

- dhe Komuna e Rahovecit do ta bëjnë të njëjtën gjë nesër dhe të aplikojmë për këtë projekt ndër komunal . Afatet janë të tilla sepse nuk kemi mbledhje të Kuvendit në këtë muaj andaj duhet të votojmë sot sepse e humbim afatin për aplikim të këtij grandi .

z. Agon Batusha: Ne si Lëvizje Vetëvendosje kërkojmë që të hyj si pikë e rendit të ditës Diskutimi për Stacionin Transfer të Mbeturinave sepse ditëve të fundit ka djegie të mbeturinave dhe ndotje të madhe të ajrit , andaj kërkojmë që kjo të jetë pikë e rendit të ditës për këtë mbledhje .

znj. Edi Puka: Fillimesh të gjithë veteraneve dhe qytetareve ju urojme sot përvjetorin e themelimit të Brigadës 137 Gjakova. Pse nuk është përfill Vendimi i MAPL-së për rishqyrtimin e Vendimit të mbledhjes së Kaluar për heqjen e Interesit publik për pronat rreth kullës Sylejman Vokshi, sepse afati Kohor është 30 dite dhe deri në atë kohë ne nuk kemi mbledhje tjetër të rregullt, andaj propozojmë që kjo pikë të jetë si pikë e rendit të ditës për këtë mbledhje ose ne të kundërtën ne do ta lëshojmë sallën sepse nuk dëshirojmë të jemi pjesë e proceseve të jashtëligjshme .

znj. Diana Qarkagjia: Ne mbledhjen e fundit të Kuvendit ka qenë një raport nga Stacioni i Autobusëve kurse pas pak ditëve kanë filluar disa ndërtime për të cilat ne kërkojmë informacione se çfarë po ndodh me atë pjesë dhe kërkojmë të jetë si pikë e rendit të ditës .

z. Bekim Ermeni : Ne emër të LDK-së e falënderoj MKRS-në që një vendim të pa ligjshëm e ka kthyer prapa dhe ka kërkuar që të mbetet në fuqi vendimi i vitit 2015. Meqenëse 3 herë u dërguar në Kuvend ajo pikë dhe në fund u kthye se nuk kemi pasur të drejtë, të sqarohet sot këtu në Kuvend pse ka ndodhur kjo dhe pse po veprohet në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe pse po duhet të ndërhyj institucionet qendrore .

Kryetari : Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e ka pranuar një letër nga Ministria për Kulturë Rini dhe Sport lidhur me një vendim të Komunës i cili është plotësisht i ligjshëm dhe i drejt, dhe MAPL-ja ka kërkuar nga ne sqarime për ata pikë ne ju kemi dërguar ato sqarime. Ka qenë gabim referimi tek MKRS-ja sepse vendimi jonë nuk ka të bëjë fare me atë ministri , çështje tjetër është se i pa ligjshëm ka qenë veprimi i MKRS-së sepse krejt çka ka bërë Komuna e Gjakovës ka qenë me e hek nga eksproprijimi ato prona dhe kjo nuk ka lidhje me këtë ministri por me Ministrinë e Financave. Ministria e Kulturës mundet që Komunën e Gjakovës mos me e lejuar me dhënë leje me afër se 50 metra që në nuk e kemi në plan me e lejuar këtë por jo me ndërhyrje çështje pronësore siç ka bërë tani sepse nuk ka institucion që mundet me e detyruar Komune me bërë shpronësime andaj ne ju kemi drejtuar edhe MAPL-së dhe DKRS-së, andaj jemi në afate kohore dhe do të veprojmë në pajtueshmëri me procedurat ligjore .

znj. Florentina Gjergjaj: Meqenëse jemi në muajin Mars muajin e gruas unë dua të ndërlidhem pikërisht me diskutimet paraprake dhe me mbledhjen kaluar dhe atë që ka ndodhur pas mbledhjes, sepse keni parë propagandën dhe linçimin ku ne një pano janë vendosur fotografitë e të gjithëve që ne mbledhjen e kaluar e kemi votuar pro vendimit, dhe është mbishkrimi turpi i Gjakovës pra ne sipas tyre qenkemi turpi i Gjakovës, dhe kjo pano është publikuar në faqen e Alternatives, dhe duke nxitur urrejtje dhe duke nxitur opinionin publik me bërë me gisht nga ne. Duke qenë se në këtë mes ka edhe Femra, Nene, gra, Familjare, profesioniste, mësimdhënës dhe e përfaqësojnë dikë këtu në mënyrë të drejtë dhe legjitime, andaj kërkoj nga ju zonja te Alternatives që të distancoheni nga ky publikim edhe pse e keni përkrah në maksimum këtë ide fyese dhe se keni komentuar se këta nuk janë të Gjakovës, andaj unë po ju pyes juve se nga qenkemi ne sipas jush këto propaganda të pa moralshme dhe fyese ju takojnë shekujve të kaluar e jo kohës që po jetojmë sot .

Për znj. Drita Buza e cila në mbledhjen e kaluar na ka propozuar ne si pozitë që të shkollohem unë po i propozoj asaj dhe partisë se saj që të edukohen e mos të bëjnë shpifje dhe fyerje të tilla . Sa i përket patriotizmit të tyre unë po ju kujtoj se në atë pano ka njerëz që e kanë dëshmuar veten në kohën kur ka qenë e nevojshme dhe vazhdojnë edhe sot . Për të gjithë ata që vazhdojnë me këto propaganda të shekullit 15 fituesin e Gjakovës e ka dëshmuar qytetari me votën e lirë .

znj. Hana Zeka : Edhe ne mbledhjen KPF-s e kemi kërkuar por nuk i kemi marr mbështetjen e nevojshme që të futet si pike Shfuqizimi i Planit Rregullues Gjakova 2005 sepse janë shfuqizuar edhe plane tjera dhe konsiderojmë se ky plan është në kundërshtim me ligjin për trashëgimin kulturore dhe me ligjin për Planifikim Urban. Për atë që u tha nga Kryearti për rekomandimet e MAPL-së mendoj se veprimet e tyre janë në harmoni me ligjet .

znj. Mimoza Shala: Fillimisht ju uroj të gjithë bashkëluftëtarëve dhe qytetareve 20 vjetorin e themelimit të Brigadës 137 Gjakova dhe kërkoj që të futet si pikë e rendi të ditës votimi i deklaratës për të cilën e kemi ftuar mbledhjen e jashtëzakonshme , ka pasur kritika se nuk janë ftuar të gjitha për me e nënshkrua kërkesën , por askush nuk e ka kundërshtuar këtë deklaratë andaj kërkojmë që të futet sot si pikë e rendit të ditës .

z. Bekim Jupa: Sa i përket kësaj kërkesë nëse vjen në emër të grupit të grave asambleiste në do ta përkrahim por jo me ardhë në emër të një subjekti politik, por sa i përket rendit të ditës ne kërkojmë që të qitet në votim rendi i ditës ashtu siç e kemi marrë me ftesën për mbledhje .

znj. Mimoza Shala : Për mua është e rëndësishme me u miratuar kjo deklaratë, pa varësisht se nga kush vjen dhe është mire me u përkrah edhe nga te dy gjinitë .

Kryesuesi: Kërkoj që të harmonizohet teksti dhe pastaj të shpërndalet për natarët e kuvendit . Fillojmë me propozimet për rend dite fillimisht e kemi propozimin e kryetarit të Komunës për Bashkëpunim ndër komunal me komunën e Rahoveci, Kush është që jo pik të hyj në rend ditës si pikë e tretë e rendit të ditës, Kush është: Por, kundër, abstenim .

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u votua kështu : 28 pro, 0 kundër , dhe 2 abstenim

Kryesuesi: E qes në Votim që kërkesa e z. Agon Batusha diskutime për Stacionin Transfer të Mbeturinave të diskutohet në këtë mbledhje si pikë e rendit të ditës . Kush është: Pro , Kundër , Abstenim
Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u votua kështu : 28 pro, 0 kundër , dhe 2 abstenim .

Kryesuesi : E qes në Votim që kërkesa për diskutim lidhur me ndërtimet tek stacioni i autobusëve të diskutohet në këtë mbledhje Kush është: Pro , Kundër , Abstenim
Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u votua kështu : 12 pro, 1 kundër, dhe 17 abstenim .kjo pik nuk kalon për diskutim në këtë mbledhje

Kryesuesi : E qes në Votim që kërkesa e znj. Edi Puka për diskutim lidhur me rekomandimin MKRS-së për rishqyrtim të Vendimit për parcelat afër Kullës Sylejman Vokshi të diskutohet në këtë mbledhje .
Kush është: Pro , Kundër , Abstenim
Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u votua kështu : 12 pro, 17 kundër , dhe 1 abstenim .kjo pik nuk kalon për diskutim në këtë mbledhje

Kryesuesi : E qes në Votim që kërkesa e znj. Hana Zeka për diskutim në këtë mbledhje kërkesën lidhur me Shfuqizimin e Planit Urbanistik Gjakova 2005 .Kush është: Pro , Kundër , Abstenim
Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u votua kështu : 5 pro, 18 kundër , dhe të tjerët abstenim, kjo pik nuk kalon për diskutim në këtë mbledhje

Kryesuesi: E qes në Votim kërkesën e znj. Mimoza Shala që të diskutohet për këtë mbledhje miratimi i Deklaratës kundër dhunës ndaj grave .
Kush është: Pro , Kundër , Abstenim .Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u votua kështu : 24 pro, 1 kundër , dhe 0 abstenim .kjo pik kalon për diskutim në këtë mbledhje .

- Anëtarët e pranishëm të Kuvendit nga Subjekti Politik Alternativa e lëshuan sallën .

Kryesuesi: E qes në Votim miratimin e rendit të ditës sipas ftesës së bërë, si dhe me tri pikat shtesë që u miratuan për këtë mbledhje kush është: për, kundër abstenim. Nga anëtarët e pranishëm e Kuvendit të Komunës **u votua kështu: 19 pro, 0 kundër , dhe te tjerët abstenim .**
Pas votimit u miratua Ky :

REND DITE

- 1.Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me dt. 04.03.2019 .
- 2.Nisma për Bashkëpunim Ndër komunal me komunën e Rahovecit
- 3.Informata e Kryetarit të Komunës për Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2019.
- 4.Informata vjetore Financiare për vitin fiskal 2018.
- 5.Bartja e të hyrave vetanake nga viti fiskal 2018, në buxhetin e vitit 2019 .
- 6.Shqyrtimi i Propozim Vendimit për fillimin e procedurave për Hartimin e Hartave Zonale Komunale me Programin e Punës për Hartimin dhe Menaxhimin e të njëjtës .
- 7.Raporti Vjetorë i punës së Zyrës së Personelit për vitin 2018 .
- 8.Themelimi i Komisionit për Plotësim Ndryshimin e Rregullores së Punës së Kuvendit .
9. Diskutim lidhur me Stacionin Transfer të Mbeturinave .
10. Shqyrtimi i Deklaratës për adresimin e pabarazisë gjinore dhe veprimet që duhet të përmbushen në funksion të barazisë së plotë gjinore
11. Të Ndryshme .

1. Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 04.03.2019

Kryesuesi: Për këtë pik të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 04.03.2019 a ka dikush ndonjë vërejtje ose sugjerim sa i përket këtij procesverballi .

z. Bekim Ermeni : Një gabim teknik ka ndodhur ne faqen 7 ku diskutimi i kolegut z. Bekim Jupa është shënuar Bekim Ermeni , kërkoj që te përmirësohet.

z. Agon Batusha: Disa gabime teknike kanë rrjedhur dhe po i humb kuptimi i fjalisë tek të ndryshme, kur unë kam kërkuar që komuna të ndërhyjë për ndaljen e djegies së mbeturinave në stacionin Transfer.

z. Zef Komani: Në mbledhjen e kaluar fjalimin e kame filluar me Unë si psikiatër, dhe kamë vazhduar me diskutimin për kullën e Sylejman Vokshit dhe nëse lexohet pas 50 viteve thonë se Psikiatri çka ka pasur lidhje me Monumentet e Kulturës, por kur e kam cek unë si psikiatër kam pas fjalën për sjelljen e disa individëve brenda sallës .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime E qes në Votim miratimin e Procesverbalit me vërejtjet e paraqitura .
Kush është: për, kundër, abstenim.

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **Unanimisht u votua por procesverbalit** nga mbledhja e kaluar e mbajtur me dt. 04 .03.2019 .

2. Pika e dytë e rendit të ditës: Nisma për Bashkëpunim Ndër komunal me komunën e Rahovecit

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i Propozim Vendimit për Nisma për Bashkëpunim Ndër komunal me komunën e Rahovecit, andaj e ftoj Kryetarin e Komunës z. Ardian Gjini që ta merr fjalën .

Kryetari : Për këtë pikë kemi Nisma për Bashkëpunim Ndër komunal me komunën e Rahovecit ne mënyrë që të kemi mundësi për me aplikua për grand për të cilin jemi dakortuar me kryetarin e Rahovecit z. Smajil Latifi për ndërtimin e pendës se Drinit të Bardh kjo është edhe qëllimi i kësaj nisme .

Kryesuesi: E Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime, e qes në votim, miratimin e Vendimit për Nisma për Bashkëpunim Ndër komunal me komunën e Rahovecit **kush është për, kundër, abstenim.** Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës unanimisht u votua pro . Pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Miratohet NISMA për Bashkëpunimin Ndër Komunal në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës se Rahovecit .

2. Bashkëpunimin Ndër Komunal në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës së Rahovecit, do të bëhet në fushën e Infrastrukturës për projektin e Pendës së Drinit të Bardhë nga fondi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

3. Autorizohet Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini që ti filloj Konsultimet dhe përgatitjen e Propozim Marrëveshjes për bashkëpunim Ndër Komunal.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

3. Pika e tretë e rendit të ditës: Informata e Kryetarit të Komunës për Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2019.

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Informata e Kryetarit të Komunës për Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2019.andaj e ftoj Kryetarin e Komunës z. Ardian Gjini që ta merr fjalën .

Kryetari: Planin e Punës e kemi marre dhe është një plan i zgjeruar ku janë të përfshira aktivitetet e drejtorive dhe të zyrave të Komunës . Unë do të ju paraqes në pika të shkurtër ku se pari kemi një stabilizim të financave ku në këtë vit do të provojmë që ti fshijmë diku $\frac{3}{4}$ e borxheve të akumuluar dhe në vitin e ardhshëm mos të kemi borxhe, pika tjetër është që të kemi rritje të të hyrave, çështje tjetër është vazhdimi i shtrimit e rrugëve dhe i shtruarjes se infrastrukturës bazike, sepse kemi ende disa rruge që të përmbyllet shtruarja e rrugës, e njëjta gjë do të ndodh me ndriçim. Për arsimin dhe shkollat do të vazhdojmë me standardin Minimal, ku në këtë vit do të mbyllet çështja e nyjave sanitare do të vazhdojmë me ngrohjen

qendrore dhe me gjelbërimin e oborreve, kemi disa pika të investimeve që janë nga zhvillimi ekonomik por kane të bëjnë edhe me pika rekreative siç është rruga për ne Majën e Kurorës , Rruga e Radoniqit , shpella e Kusarit si dhe disa projekte të tjera, sot e morëm vendimin për aplikim për pendën e drenit të bardh dhe shpresojmë të fitojmë grandin dhe nëse nuk e fitojmë atë grand ne vitin e ardhshëm do të buxhetojmë me mjete të komunës. Për infrastrukturën e madhe në këtë verë do të kryhet qarkorja për Prizren, Tranziti i ri nga Ura e Nakarades deri tek Pika e zezë është prokurua dhe besoj se shumë shpejt do të fillojmë me punime, rruga Bujar Roka do të vazhdoj sa po të kryhen procedurat. Ministria i ka filluar punimet për Rrugën Gjakovë Dollc, për ujin e pijes në këtë vit do të kyqen diku 95% e qytetareve të Komunës së Gjakovës në sistemin e ujit të pijes, po ashtu do të punohet në penda dhe kanale të ujitjes është rritur fondi për këtë qëllim dhe do të investojmë aty ku ka nevojë , e kemi një marrëveshje me MEF për kanalizimin e frashitit qëpremtuar se ato mjete do të barten në këtë vit dhe të përfundoj ai projekt .çështje tjetër është nisja e punës me asetet komunale që i kemi krijuar disa grupe punues për fillimin e punës së aseteve të Komunës që kanë qen jashtë përdorimit që një kohë të gjatë ato grupe tani janë në përfundim të raprote të tyre dhe do të dalim me propozimet konkrete. Do të fillojmë me punët e Lumit krena . Në Gjakovë do të nis ndërtimi ngrohtores se re që është ko gjenerim me biomasë, ndërtesa e re e komunës do të vazhdoj por e kemi një ngecje sepse analizat siç duhet në objektin e vjetër të komunës dhe pasi që kanë filluar punimet ka dal se shtyllat e objektit të vjetër nuk janë në nivelin e duhur që është vërtetuar në 2016 dhe tani k mbetur të bahet analiza se sa do të jetë e mundshëm sanimi i shtyllave ose të rrënohet ai objekt, në kemi premtuar se nëse ka nevojë ne si komunë do të ndajmë buxhet për vitin e ardhshme për këtë projekt . Për stacionin transfer është mbyll ai dhe ka zjarr vënie të qëllimshme në këtë viti përpjekje për fillimin ndërtimit të impiantit për riciklim . Ky stacion është mbyll lëndet kanë shkuar në prokurori sepse ka pas shkelje dhe ka pasur pengesa , ne kemi kërkuar asistencë nga FSK-ja dhe nga KFORI që të bëjnë hapjen e rrugës për me intervenua për ndaljen e djegies së mbeturinave sepse kopanit lokale nuk kanë arritur që të depërtojnë për ndaljen e zjarrit në këto mbeturina . Do të kemi shumë punë në infrastruktura si do të rrënohet ra për Prishtinë , tjetra për Prizren, si dhe të gjitha rrugët në çarshinë e vjetre do të rishtrohen .

z. Agon Batusha: Ne duam të ngrisim edhe një herë shqetësimin për ujin e rekes së keqe sepse është premtuar nga vet kryetari dhe ende nuk është kryer si dhe ndertin e shkollës në Ponoshec që është kërkesë e kamotshme, ka pasur premtime nga të gjithë deputetët por nuk është ngritur kjo çështje nga asnjëri në përjashtim të deputetes znj. Nagavci por gjithsesi duhet të realizohet ky projekt, si dhe duhet të ndërtohen kopshte nëpër fshatra si dhe të rinovohet kopshti në Damjan ose të ndërtohet i ri . Lagjja Rezina ka pasur pak investime dhe ka ndërtime pa leje ka nevojë për kanalizim , për ndriçim për rrugë, etj . Urojmë që sa më parë të përfundojnë investimet për gjërat elementare .

Kryetari: Për shkollën në Ponoshec është buxhetura por e njëjta shkollë po ndërtohet në Korenic në të gjitha dokumentet e Qeveris së Kosovës figuron se po ndërtohet shkolla në Ponoshec a në realitet po ndërtohet në Korenic , vendimi për me e hekë këtë shkollë nga Ponosheci në Korenic ka qenë vendimi jo i keq por procedurat nuk janë ndjekur dhe është bërë vendim i pa ligjshëm andaj tani kemi hasur në këtë problem, jemi duke punuar për këtë çështje . Për çerdhen në Damjan e kemi dërguar kërkesën në Ministri të Arsimit që të ndërtohet çerdhja dhe shkolla në Damjen do të ndërtohen çerdhe në të gjitha regjionet e Komunës së Gjakovës , për lagjen rezine ne do të investojmë në këtë lagje e kemi në plan por aty ka probleme me prona dhe do të bëjmë një zgjidhje .

z. Edmond Dushi: Meqenëse diskutimi para se me e miratuar rendin e ditës u tej zgjat andaj u tha nga kryetari se lidhur me rekomandimin e MAPL-ës dhe të MKRS-se ju kemi dërguar një shkresë andaj kërkojmë që të na dërgoni atë shkresë apo ta publikoni në faqen zyrtare të komunës, KDI-ja e ka shpallur Gjakovën si Komuna me nivelin më të lartë të transparencës për çka ju përgëzoj, por ne lidhje me këtë planin e punës së vitit 2019 ka qenë mire që paraprakisht të na dërgohet një raport i punës lidhur me realizimin e planit të punës së vitit 2018 se a janë realizuar apo në cilën fazë gjinden . Plani i punës për këtë vit është me i

mire se i viteve të kaluar por përsëri objektivat nuk janë të qarta, për projektet që u përmenden nga z. Agon Batusha ato duhet të përpilohen kur të miratohet KAB-i ose Buxheti i Komune sepse tani është vonë .

z. Bekim Jupa : Para një viti kur është diskutuar për planin e vitit paraprak këtu kemi biseduar dhe kemi kërkuar nga drejtori i DKA-së që të bëjë rregullimin e dokumentacionit për bartjen e asaj shkolle sepse ketë të gjithë janë munduar për shkollën e Ponoshecit por meritat me të mëdha i ka deputeti i PDK-s z. Hajdar Beqa sepse deputetet tjerë as një herë e se kanë ngritur zërin pre ketë Shkollë, edhe projekti i ujit te rekes se keqe është projekt i qeveris Thaqi 2 dhe ne ketë vit janë ndarë mjetet me iniciativën e deputetit Beqa .

z. Haxhi Sejdiu: Kryetari e ka sqaruar se uji i pijes nuk është në menaxhimin e Komunës por nën menaxhimin e KRU Gjakova, Kompani kjo e cila është ka për përfermon me se miri ne Kosovë, ky projekt është stërgjatë dhe tani kemi premtime se ky projekt do të përfundoj nga mesi i nëntorit. Për sa i përket asaj qe po kërkon me ndërtuar qerdhe të fëmijëve a keni dal ne teren dhe a keni shikuar se a ka fëmijë ne ato fshatra sepse për çdo dit po zvogëlohet numri i fëmijëve .

znj. Dafina Syla : Qe nga fillimi i mandatit unë kam kërkuar qe te kemi një plan për çështjen e strehimit për ato familje qe kane nevojë sepse ka shumë te tilla dhe po përballen me probleme te vazhdueshme , jemi ne dijeni se ky problem është i trashëguar por ne si komunë duhet te merremi me ketë çështje , si dhe a është formuar ndonjë komisionin për verifikimin e këtyre banesave. E falënderoj publikisht drejtorin e Shërbimeve Publike për realizimin e kërkesës time për ndriçimin publik ne Fshatin Duzhnje .

Kryetari: Janë duke punuar dy grupe punuese, njëri është duke punuar për evidentimin e banesave qe janë pronë e komunës dhe nuk janë sociale, ndërsa grupi i tjetër është duke i evidentuar personat ose familjet qe jetojnë ne banesat sociale por nuk i plotësoj kriteret për banim social dhe në të njëjtën kohë i kemi përgatitur dokumentet për hapjen e rrugës që na mundëson për ndërtimin një banese të re për banim social kërkesën e kemi bërë në Ministri dhe shpresoj se shpejt do të realizohet ky projekt.

z. Zef Komoni: E falënderoj Ekzekutivin që e ka prezantuar ketë plan të punës por nëse e marrim dhe e analizojmë ketë plan të punës shumë projekte që janë premtuar nga kryetari nuk figurojnë këtu, po flitet këtu për ujësjellësin e Rekes së keqe i cili patjetër duhet të kryhet por duhet të flasim edhe për ujësjellësin e Brekiocit Firzes dhe të Zhubit që nuk janë as tri kilometra nga Qyteti dhe nuk kanë uji të pijes, çështje tjetër është një rrugë është afër 70 metra që është një rrugë nga Brekoci i ultë e shkon nga shkolla fillore ku afër 300 nxënës duhet me i bërë nga 4 kilometra në dit andaj kërkoj që të bëhet shpronësimi i kësaj rrugë dhe të kryhet në ketë vit . Shpresoj se janë gabime teknike në planin e Punës ku janë blerja e GPS ku për Kadastër kushton 10,000 euro ndërsa për Tëtimin në Pronë vetëm 1000, andaj kërkoj sqarime, tek blerja e luleve dhe kurorave 12.000 euro shpresoj që të jetë gabim teknik gabim tjetër është digjitalizimi 180.000 euro shtyllat multifunksionale te qytetit , furnizimi me artikuj higjenik 120.000 euro shpresoj që janë gabime teknike, furnizimi me ngjyra për molerin për shkolla me sa di unë këto shërbime behën me tender dhe me material të firmës fituese, pastrimi dhe larja e automjeteve te komunës së Gjakovës 12.000 euro është shumë tepër e madhe, tek nderimi dhe asfaltimi i rrugës në Ramoc shënon lagjja Hajdaraj ndërsa janë të aprovuar edhe dy tjera .

Kryetari: Shumica nga ato qe u përmenden nga ju z. Komani janë kontrata dy vjeçare dhe kjo është plani i Punës dhe jo Buxheti, tek çështja e shifrave dhe e procedurave kanë me kalua nëpër disa filtra dhe nuk lejohen gabimet, për GPS janë te tjerë për Tatimin ne Pronë dhe të tjerë për Kadaster sepse përdorën për qëllime të ndryshme.

znj. Florentina Gjergjaj: Dua të ndalemi tek disa gabime teknike gjatë parashtrimit te objektivate sepse drejtorit i kanë specifikat e veta, por e kisha veçuar DZHE për realizimin teknik të planit sepse objektivat janë të qarta sidomos në aspektin kohor . Drejtoria e Shëndetësisë në konceptin e zgjerimit të shërbimeve ku

deri me tani ka vetëm shërbime ambulatorie a keni menduar që të ketë ndonjë objektiv me afatgjatë që të zgjerohet kjo objektiv shëndetësore si dhe nuk pash ndonjë projekt për dada bazën ose digjitalizimin e sistemit të shëndetësisë ose te sistemit të vaksinimit .

z. Muharrem Musa: Sa i përket asaj që u përmend nga z. Batusha lidhur me deputetet e caktuar Kosova ka pasur deputet dhe qeveri edhe në të kaluarën por sa investime kanë ardhur në Gjakovë nga niveli qëndro deri me tani sa është Kryeministre z. Ramush Hradinaj andaj duhet ti gëzohemi të gjitha këtyre investimeve dhe këtyre projekteve sepse janë projekte për të gjithë qytetaret e Komunës së Gjakovës .

z. Bekim Jupa: Mirë është që te përcjellën politikat në mënyra kontinuele e jo te filloni nga sot, shikojë mirë se kur ka filluar projekti i ujësjellësit të rrekës së keqe dhe nga cila qeveri ka nis .

znj. Adelina Shehu-Kola: Digjitalizimi i monitorimit të orarit të punës është planifikuar sepse Kujdesi Primar Shëndetësor i ka 26 qendra, sa i përket vaksinimit të gjitha QFF-të janë në funksion për vaksinim ndërsa sa i përket aj që nuk ka funksionuar qendra në Ponoshec ka qenë në funksion qendra në Molliq dhe personeli ka qenë i vendosur në Molliq dhe i kemi të gjitha të dhënat në data bazë.

z. Muharrem Musa: Në qeverisjen e kaluar nga Projekti i ujit të rekes së keqe ju kanë hekur mjetet, andaj duhet të falënderohet kjo qeveri që tani po e implementohet ky projekt .

Kryesuesi: Meqenëse Nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur diskutimin për këtë pik të rendit të ditës .

4. Pika e katërt e rendit të ditës: Informata vjetore Financiare për vitin fiskal 2018.

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Informata vjetore Financiare për vitin fiskal 2018, materialet i keni marrë me kohë, andaj e ftojme z. Durim Halilaj që ta merr fjalën .

z. Durim Halilaj: Duke u Bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Drejtoria për Buxhet dhe Financa e ka përgatitur Informatën Financiare Komunal për periudhën Janar – Dhjetor 2018, e cila behët bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e Buxheti i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës me Ligjin Nr.-06/L-020 për Komunën e Gjakovës është në vlerë = 23.266.602,53€ , buxheti gjatë vitit ka pësua ndryshime në vlerë 2.625.376,80€ në total ka arritur vlerën =25.891.976,33€ . Përveç Grandeve të marra nga niveli qendror, për qëllimet e shpenzimeve të përgjithshme, Komuna ka grumbulluar edhe të hyra vetanake. Ekzistojnë disa kategori kryesore të hyrave vetanake komunale: tatimin në pronë, gjokat e trafikut, Kompensimi për rregullimin e tokave ndërtimore, shërbimet e kadastrave, dënimet nga Gjykata etj. Të hyrat totale vetanake të grumbulluara Janar-Dhjetor 2018 kanë arritur në shumën prej 3.721.614,9€ që përbën 118,48% të planifikimit (3.141.143,00€). Pagat dhe mëditjet - mjete të pranuar në vlerë 13.309.538,52€ janë shpenzuar 13.252.490,92€ apo 99,57% të mjeteve të alokuara, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak shpenzimi është lartë për 3,89% - rritje e pagave .pagat në shpenzimet e përgjithshme Komunal janë 57,35% .Mallrat & shërbimet- mjete të pranuar në vlerë 2.441.942,68€ janë shpenzuar 2.234.274,89€ në përqindje 91,50% e mjeteve të alokuara, krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzim me të lartë për 129,19.Pjesëmarrja e Mallrave & Shërbimeve në shpenzimin e përgjithshëm Komunal është 9,67 % .Shpenzimet komunale (Komunalit) - mjete të pranuar në vlerë 578.736,20€ janë shpenzuar 549.083,33€ ose në shkallën prej 94,88% të mjeteve të alokuara, krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzim më të lartë për 103,71%. Pjesëmarrja e shpenzimeve komunale në shpenzimin total komunal është 2,38%. Subvencionet - mjete të pranuar në vlerë 504.155,24€ janë shpenzuar 459.572,71€ në përqindje prej 91,16% të mjeteve të alokuara, krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzim më të lartë për 102,09%. Pjesëmarrja e Subvencioneve në shpenzimin total Komunale është 1,99% Shpenzimet kapitale - mjete të pranuar në vlerë 8.173.027,50€ të kjo kategori kemi një shpenzim prej 6.613.965,16€ apo në përqindje 80,92% mjeteve të alokuara, krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime

me te larte për 120,76% .Pjesëmarrja e Shpenzimeve kapitale ne shpenzimin total Komunal është 28,62% .Buxheti i alokuar ne total është realizuar 92.41%, krahasuar me periudhën e vitit paraprak shpenzimi është më i larta për 110.35% .

Vërejtje : Te alokimet 2018 nuk është paraqit vlere 580.471.90€ mjete këto të grumbulluara më shumë nga të hyrat e planifikuara buxhetore sepse këto të hyra alokohen pasi të nxirret vendimi nga Kuvendi dhe pastaj bëhet shpërndarje sipas kodeve ekonomike.

z. Agon Batusha: Sa i përket këtij raporti e falënderojmë drejtorin për një raport te kompletuar dhe kjo është një shenje që kur të merren për bazë kritikën e tona për bazë atëherë raporti bëhet me i kompletuar.

U përmend nga drejtori se Buxheti është tejkaluar për 580.471.90€ në krahasim me planifikimin, ku janë shumë zëra buxhetor që nuk e kanë arritur as kuotën ndërsa janë pak zëra buxhetor që e kanë tejkaluar shumë fish planifikimin e njeri nga ata zëra është rregullim i tokës ndërtimore që janë paplanifikuar 164 ,000 euro e janë grumbulluar mbi 603,000 euro , 280.000 euro, dënimet ne trafik ne 680,000 euro qe vetëm këta dy zëra ja japin komunës 422,000 euro me shumë . Ne mbledhjen e KPF-së u kërkua një raport nga përfaqësuesi i LDK-së për lejet e ndërtimit kujt i është dhënë leja e kujt i është refuzuar . Disa zëra buxhetor janë me inkasim të ultë siç janë të hyrat nga parkingjet, ku Gjakova është ngulfatur nga parkingjet dhe komuna nuk inkason asgjë andaj nëse komuna nuk ka arritur të inkasoj nga Parkingjet publike atëherë pse nuk inkason nga parkingjet private. Të hyrat nga tregjet këtu kemi një keq planifikim sepse e kemi ditur se një operator na ka borxh 60,000 euro dhe nuk është regjistruar në planifikim dhe pagesa e këtij borxhi e ka bërë këtë tejkalim . Tek shndërrimi i tokës Bujqësore në tok jo bujqësore edhe këtu kemi në keq planifikim sepse vazhdimisht e kemi tejkaluar planifikimin, Qiraja për lokalet nuk është arritur ky inkasim sepse lokalet e janë të njëjta, Janë rritur disa zëra buxhetor ne shpenzime dhe kërkoj sqarime për shpenzimet Naftë e dru sepse kur kemi shpenzuar me shumë Naftë kemi shpenzuar me pak dru dhe ne këtë vit janë rritur të dyja këto , shpenzimet ne Medikamente kemi kërkuar që të kemi rritje në vitin 2018 ka pasur rritje për çka e falënderojmë drejtoreshën, janë 25 projekte qe janë alokuar mjetet por nuk janë shpenzuar dhe kjo është keq menaxhim. Ne Tatimin ne pronë janë disa lagje qe janë nën 70% qe nuk e kanë paguar tatimin ne pronë dhe pikërisht ne ato lagje janë planifikuar shumë projekte .

z. Bekim Ermeni: Ne faqen 10 struktura e shpenzimeve sipas kodeve ekonomike në e kemi diskutuar edhe në KPF ku shpenzimet e buxhetit i kemi 23.109.000 euro kurse alokimet janë bërë janë 25.007,000 euro ndryshimi nga alokimi dhe shpenzimi është në vlerë prej 1.9 milion euro që i bien që janë par të pa shpenzuara dhe nëse ja shtojmë edhe shumen prej 300,000 nga buxheti del se shuma prej 2,2 milion euro janë të pa shpenzuara që tregon menaxhimin e mirë të komunës që nuk ka mundur ti shpenzoj këto mjete dhe nëse flasim për borxhin komunal, qe komuna ne vitin 2019 del me borxh prej 2.6 milion euro ky borxh është si pasoj edhe nga vitet paraprake edhe nga viti 2018 ku ne tabela shihet se aj 4.2 milion euro qe po thotë drejtori është i grumbulluar edhe para vitit 2104. Komuna del me 2.6 milion euro borxh ne vitin 2019 qe është i bartur me vite të tëra ku kemi bor edhe para viti 2014qe kapin vlerën 1.4 milion nga viti 2014 deri ne vitin 2018 që kapin vlerën 2.4.miljon dhe afër 600,000ne viti 2018 qe krejt se bashku 4.6 milion . Shpenzimet që i kemi të paraqitur në raport nga 25.891.976,33€ te buxhetit te miratuar i kemi harxhuar 23 milion ose 2.2 milion nuk i kemi harxhuar dhe këtyre shpenzimeve i kemi disa shpenzime që i ka marrë gjykata ne vlerë prej 1.1.miljon dhe nëse këtyre shpenzimeve ja heqim edhe këtë vlere del se 3.4 milion euro komuna e Gjakovës nuk ka shpenzuar fare andaj a është menaxhuar mirë ky buxhet le ta vlerëson qytetarët e Komunës së Gjakovës .

z. Edmond Dushi: Unë i kam disa pyetje që janë me shqetësuese për mua lidhur me këtë informatë financiare për vitin fiskal 2018 që kanë të bëjnë me shpenzimet, ku në faqen 32 suficiti ka dal 370,000euro ku rreth 300,000 euro janë vetëm tek drejtoria për shërbime publike, në faqen 35 tek tabela për shpenzimet buxhetore janë vendimet nga gjykatat 1, 150,000 euro kërkoj sqarime pse kjo shumë aq e madhe si dhe në faqen 45 eksproprijimi tek Kulla Sylejman Vokshit janë 436,000 euro, si dhe në faqen 49 deri në faqen 74

janë subvencionet janë disa emra që kanë përfituar me shumë se një herë andaj kërkoj sqarime pse kanë përfituar disa herë këta persona.

z. Durim Halilaj: Sa i përket të hyrave që u ngrit nga z. Batusha nëse bëjmë një analizë tek të hyrat zërat buxhetor disa i kanë tejkaluar planifikimet e disa kanë ngecur por në përgjithësi kemi ngritje të të hyrave, se cila drejtori i ka kaluar të hyrat dhe nuk është e vërtetë ajo që po thuhet se janë dy ose tre zëra buxhetor që e kanë shkaktuar këtë ngritje të të hyrave. Për shpenzimet po ju sqaroj se në mallra dhe shërbime para një vitit kanë qenë 350,000 euro borxhe dhe kjo është arsyeja, për shpenzimet e naftës dhe të druve në këtë vit në të gjitha shkollat kanë pasur nxehe sipas normave dhe standardeve por ka pasur rënje të shpenzimeve për karburante të automjeteve. Tek alokimet dhe shpenzimet që u përmenden nga z. Ermeni mjetet e pa shpenzuar janë 2.2 milion 300,000 euro projekti i kanalizimit në fshatin Cermajn që e kemi premtimi nga Ministrit Hamza që do të kthehen ato mjetet për realizimin e këtij Projekti, që mbesin 1.8 milion, tek tejkalimi i të hyrave prej 580.000 euro që janë këtu por edhe 1.2 milion euro nuk kemi pasur mundësi me i paguar sepse puna nuk është kryer. Tabelat e borxheve janë të hartuara shumë mirë dhe qarta me të gjitha sqarimet e nevojshme. Nuk e përmendi askush se Komuna e Gjakovës i ka humbur 68,000 euro na përmbaruesit si pasojë e urdhërësive që janë dhënë pa pasur mjete të planifikuara. Në vitin 2017 kanë pasur suficit nga grandit qeveritar 700.000 euro ndërsa tek ne kemi vetëm 17,000 euro sepse këto 300,000 do të kthehen ky është dallimi. Eksproprijimet janë të cekura të gjitha me emra dhe 1.1 milion janë tek Kulla.

Kryetari: Rritjen me të madhe të të hyrave që ka ndodhur ndonjëherë në Komunen e Gjakovës pa e ndrruar as një norm as një taksë e kemi tani, dhe për këtë i falenderoj qytetarët për korrektesinë që është refleksion i korrektesisë së qeverisjes. Sa i përket Parkingjeve lokaleve, banesave janë krijuar të gjitha grupet dhe pasi të kryehet punën do të dergojmë këtu në Kuvend, për gjykatat as një lëndë në këtë vit nuk e kemi humbur në gjykatë por kanë qenë borxhe dhe jemi detyruar me i pagu. Tek Suficiti ju kemi thenë edhe në fillim të vitit që kemi projekte që me paramas kushton 100,000 e buxheti ka qenë 8000, si ka mundësi me e hap procedurën për këto projekte atë buxhet ka qenë Buxhet elektoral dhe ejan hapur të gjitha rruget për ndërtim dhe nuk kanë pasur mëtej as përsefermi, shpenzimet për karburant dhe për dreka dhe darka janë ulur po i kemi paguar borxhet e viteve të kaluara.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime të tejetra i shpalli të mbyllura diskutimet për këtë pikë.

5. Pika e pestë e rendit të ditës: Bartja e të hyrave vetanake nga viti fiskal 2018, në buxhetin e vitit 2019.

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Bartja e të hyrave vetanake nga viti fiskal 2018, në buxhetin e vitit 2019. E ftoj drejtorin z. Durim Halilaj që ta marrë fjalën.

z. Durim Halilaj: Drejtoria për Buxhet dhe Financa e ka përgatit dokumentacionin për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara nga buxheti i vitit 2018 në buxhetin e vitit 2019 që në total janë 1.833.476 euro, në këto kategori ekonomike: Paga dhe mëditje 24,600.00 €, Mallra dhe shërbime 143,110.57 €, Shpenzime Komunale 25,826.06 €, Subvencione 42,000.00 € Shpenzime kapitale 1,597,939.93 € -**Totali 1,833,476.56 €**, Nga vlera totale 1,833,476.56 €, vlera prej 1,253,001.66 € janë të hyra të pa shpenzuara të bartura nga vitet paraprake, ndërkaq vlera prej 580,474.90 € janë të hyra të tejkaluara nga plani i vitit 2018.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime, e qes në votim, Bartja e të hyrave vetanake nga viti fiskal 2018, në buxhetin e vitit 2019. **kush është Për, Kundër, Abstenim.** Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës u votua kështu : 23, pro, 0 kundër, 1 abstenim. Pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

1. Aprovohet propozimi i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, për bartja e mjeteve të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2018, në buxhetin e vitit 2019, në vlerë prej: 1,833,476.56 €, sipas tabelës për shpërndarjen në këto kategori ekonomike:

1. Paga dhe mëditje.....	24,600.00 €
2. Mallra dhe shërbime	143,110.57 €
3. Shpenzime Komunale.....	25,826.06 €
4. Subvencione.....	42,000.00 €
5. Shpenzime kapitale	1,597,939.93 €
-Totali	1,833,476.56 € ,

2. Nga vlera totale 1,833,476.56 €, vlera prej 1,253,001.66 € janë të hyra të pa shpenzuara të bartura nga vitet paraprake, ndërkaq vlera prej 580,474.90 € janë të hyra të tejkaluara nga plani i vitit 2018.
3. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të angazhohet për realizimin e të gjitha procedurave lidhur me bartjen e mjeteve të pa shfrytëzuara të hyrave vetanake, nga viti 2018 në vitin 2019, në vlerë prej: **1,833,476.56 €**, sipas shënimeve të tabelës së shpërndarjes, të evidentuar në pikën e I të këtij vendimi.
4. Pjesë e këtij vendimi janë tabelat për bartjen e mjeteve buxhetore të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2018 në vitin 2019.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe me nënshkrimin nga Kryesuesi i Kuvendit

6.Pika e Gjashtë e rendit të Ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për fillimin e procedurave për Hartimin e Hartave Zonale Komunale me Programin e Punës për Hartimin dhe Menaxhimin e të njëjtës

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës kemi Shqyrtimi i Propozim Vendimit për fillimin e procedurave për Hartimin e Hartave Zonale ,Komunale me Programin e Punës për Hartimin dhe Menaxhimin e të njëjtës, e ftoj drejtorin z. Arben Bakalli që ta merr fjalën.

z. Arben Bakalli: Bazuar në rekomandimet e Ministres së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe të Ministrisë së Mjedisit lidhur me vendimin për Hartimin e Hartave Zonale Komunale të miratuar në Kuvendin e Komunës me dt. 28.02.2017 DUMM bazuar me rekomandimet dhe vërejtjet e ministrisë ju sjell për shqyrtim dhe miratim vendimin për hartimin e Hartës Zonale Komunale dhe Programin për hartim dhe menaxhimin e së njëjtës .

Kryesuesi : E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës .

znj. Albina Sadrija: Lidhur me këtë pik Fshati Morinë ka një sipërfaqe shumë të madhe dhe nuk është i përfshirë ne kode kadastrale te prezantuara ne këtë dokumente, si dhe ka disa fshatra qe nuk janë te përfshira, kërkojmë sqarime .

Kryearti: Kjo nuk ka te bej me hartat dhe e shohim ne kadastër pse ekziston kjo .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime të tjera E qes në votim miratimin e Vendimit për fillimin e procedurave për Hartimin e Hartave Zonale Komunale me Programin e Punës për Hartimin dhe Menaxhimin e të njëjtës . Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro** kësaj pike , Pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë .

V E N D I M

Për fillimin e procedurave për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Gjakovës

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim fillohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Gjakovës

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor. Harta Zonale e Komunës së Gjakovës në harmoni me ligjin përkufizohet si dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për periudhën tetë (8) vjeçare.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me Hartën Zonale të Komunës nga neni 1 i këtij vendimi, përcaktohen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe rurale në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të rregullimit dhe ndërtimit në Komunën e Gjakovës, plotëson kërkesat ligjore për rregullimin e zhvillimeve në zonën urbane dhe rurale .

Neni 4

Zonat kadastrale në territorin e Komunës së Gjakovës janë:

Kodi kadastral	Zona kadastrale	Sipërfaqja m ²	Sipërfaqja Ha
70705001	BABAJ BOKES	21.952.636	2195
70705007	BERDOSANË	10.516.590	1051
70705003	BATUSHA	9.425.412	942
70705005	BEC	15.385.911	1538
70705006	BERJAH	1.877.266	187
70713003	BISTRAZHIN	3.103.127	310
70705008	BREKOC	5.546.998	554
70705009	BROVINË	20.312.534	2031
70705079	CERMJAN	19.608.143	1960

70713017	DAMJAN	20.889.575	2088
70705020	DEVA	17.565.171	1756
70705024	DOBLIBARE	8.930.057	893
70705025	DOBRIQ	4.246.399	424
70705027	DUJAKË	5.880.565	588
70705077	FIRZA	8.721.497	872
70713016	GËRQINË	20.426.516	2042
70705017	GRGOC	9.598.717	959
70705028	GJAKOVË-J.QYTET	22.285.135	2228
70705029	GJAKOVË-QYTET	2.539.008	253
70713009	GODEN	10.664.325	1066
70705018	GUSKË	2.187.532	218
70705030	HEREÇ	5.212.950	521
70705034	JABLLANICA	7.332.754	733
70705037	JAHOÇ	10.438.679	1043
70705035	JANOSH	2.467.515	246
70705039	KODRALIA BECIT	6.096.167	609
70705042	KORENICË	5.033.844	503
70705043	KOSHARE	24.573.384	2457
70705044	KRALAN	14.929.595	1492
70705041	KODRA HUTIT	11.079.452	1107
70705045	KUSHAVEC	2.554.449	255
70713044	LIPOVEC	7.876.957	787
70705048	MARMULL	8.191.664	819
70705049	MEÇE	3.515.698	351
70705050	MOGLICË	3.856.125	385

70705051	MOLLIQ	8.432.584	843
70705052	NIVOKAZ	2.867.583	286
70705014	NOVOSELLË E EPËRME	3.078.130	307
70705022	NOVOSELLË E ULËT	3.682.673	368
70705053	ORIZE	3.951.848	395
70705055	OSEKHYLE	2.863.297	286
70705054	OSEKPASHË	1.306.630	130
70705056	PALABARDH	2.323.420	232
70705057	PETRUSHAN	16.763.284	1676
70705060	PONOSHEC	10.290.583	1029
70705061	POPOC	8.025.303	802
70705076	QERIM	7.530.716	753
70705081	ÇERRET	11.755.455	1175
70705067	RAQË	2.608.197	260
70705063	RADONIQ	11.180.861	1118
70705064	RAKOC	5.796.257	579
70710070	ROGOVË II	2.601.066	260
70713071	ROGOVË I	12.766.723	1276
70705066	RRACAJ	6.365.203	636
70705083	SHEREMET	10.498.832	1049
70705084	SHISHMON I BOKËS	12.724.274	1272
70705071	SKIVJAN	9.339.383	933
70713075	SMAÇ	4.805.336	480
70705073	SMOLICË	9.560.393	956
70705074	STUBELL	2.394.967	239
70705075	TRAKANIQ	3.398.518	339

70713080	UJZ	7.899.128	789
70705010	VOGOVË	3.552.417	355
70705012	VRANIQ	4.885.327	488
70705031	ZHABEL	12.989.235	1298
70705032	ZHDRELLË	3.389.908	338
70705033	ZHUB	7.759.963	775
70705070	ZID SADIK AGE I	2.989.440	298
70705085	ZID SADIK AGA II	876.914	87
70713029	ZYLFAJ	11.626.968	1162

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Hartës Zonale të Komunës caktohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit koordinon procesin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda komunës, në bazë të kontratës të lidhur me kontraktorin e përzgjedhur përmes procedurave të prokurimit publik sipas Ligjit.

Neni 7

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor, sipas nenit 1 të këtij Propozim Vendimi është i obliguar që Hartën Zonale të Komunës ta hartojë në afat prej pesëmbëdhjet (15) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij propozim Vendimi.

Neni 8

Konsultime Publike

Projekti i Hartës Zonale të Komunës, para finalizimit do të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Projektit të Hartës Zonale të Komunës në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e sygjërimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 9

Afati i Vlefshmërisë

Harta Zonale e Komunës hartohet për periudhën kohore 8(tetë) vjeçare.

Neni 10

Gjuha zyrtare

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhët zyrtare të komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit .

Neni 11

Programi

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë me nenin 11 pika 1.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinorë Nr. 04/L-174.

Neni 12

Hyrja ne fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

7. Pika e shtatë e rendit të Ditës : Raporti Vjetorë i punës së Zyrës së Personelit për vitin 2018 .

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Raporti Vjetorë i punës së Zyrës së Personelit për vitin 2018, andaj e ftojme z. Kushtrim Brahimin që ta marrë fjalën .

z. Kushtrim Brahimin: Duke u bazuar në Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2019 zyra e Personeli të Komune së Gjakovës për herë të parë ka prezantuar një raport . Komuna e Gjakovës gjatë vitit 2018 ka pasur gjithsejtë 318 pozita të autorizuar shërbyes civil, prej të cilave vetëm dy janë jo të karrierës, 82 janë të nivelit udhëheqës, 193 janë të nivelit profesional dhe 42 të nivelit administrativ, Plani i personelit për vitin 2018 parashikonte 58 pozita të lira për rekrutim prej tyre 42 pozita të lira nga vitit e kaluara dhe 16 do të liroheshin nga pensionimi i stafit, realizimi i Planit të personelit për vitin 2018 është arritur në nivelin 100% ku nga 48 pozita të lira kanë pasur të drejtë të konkurrojnë kandidatë të jashtëm ndërsa 9 kanë qenë konkurse për avancim. Gjatë vitit 2018 as një konkurs nuk është anuluar nga Këshilli i pavarur mbikëqyrës. Kemi pasur disa pozita me ushtrues Detyrë kryesisht neper shkolla të komunës së Gjakovës gjegjësisht drejtorët dhe zëvendës drejtorët e shkollave dhe disa pozita në administratën e Komunës . Ky raport është i Publikuar ne Veb faqen e Komunës se Gjakovës edhe pse nuk e kemi obligim ligjor por për hir të transparencës e kemi publikuar .

z. Zef Komani: Unë e falënderoj menaxherin e Zyrës së Personelit për këtë raport por e falënderoj vetëm për sa i përket formës ndërsa sa i përket përmbajtjes ne do të konsultohemi dhe do të analizojmë disa gjëra dhe diskutojmë ndonjëherë tjetër .

Kryesuesi: Meqenëse Nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës

8.Pika e tetë e rendit të Ditës : Themelimi i Komisionit për Plotësim Ndryshimin e Rregullores së Punës së Kuvendit .

Kryesuesi: Ka qenë kërkesë e shumicës së grupeve të Kuvendit që të plotësohet dhe të ndryshohet rregullorja e punës së Kuvendit andaj sot e kemi si pikë të rendit të ditës Themelimi i Komisionit për Plotësim Ndryshimin e Rregullores së Punës së Kuvendit, dhe kërkoj nga të gjitha që të japin propozimet e juaja për

anëtar te këtij komisioni ku do te përfshihen nga një anëtar i te gjitha krupeve te Kuvendit Kryesuesi i Kuvendit dhe zyra ligjore dhe shërbimi i Kuvendit .Parimisht janë shefat e grupeve por kush ka ndonjë propozim tjetër urdhëroni:

z. Muharrem Musa : Ne emër te Grupit te AAK-s e propozojmë znj. Teuta Pallaska Milla .

Kryesuesi: i kemi këto propozime : znj. Teuta Pallaska, z. Bekim Jupa , z. Bekim Ermeni , z. Agon Batusha, znj. Diana Qarkagjia, z. Edmond Dushi, z. Zef Komani, z. Shpend Kumova, Kryesuesi i Kuvendi z. Anton Shala, z. Burim Bajrami dhe z. Frrok Gjergjaj.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime të tjera E qes në votim miratimin e Vendimit për Themelimi i Komisionit për Plotësim Ndryshimin e Rregullores së Punës së Kuvendit me përbërjen e lart përmendur . Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës **u votua kështu 20 pro , 1 kundër , 0 abstenim** , Pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë .

V E N D I M

1. Themelohet Komisionit për Plotësim Ndryshimin e Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me këtë përbërje .

1. z. Anton Shala
2. znj. Teuta Pallaska Milla.
3. znj . Diana Qarkagjia
4. z. Bekim Jupa .
5. z. Bekim Ermeni.
6. z. Agon Batusha.
7. z. Zef Komani
8. z. Edmond Dushi
9. z. Shpend Kumnova
10. z. Frrok Gjergjaj
11. z. Burim Bajrami

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

9. Pika e nëntë e rendit te ditës : Diskutim lidhur me Stacionin Transfer te Mbeturinave .

Kryesuesi: Kjo pikë ka hyr ne rend dite me kërkesën e grupit te VV-s andaj e ftoj z. Kreshnik Alijaj qe ta merr fjalën

z. Kreshnik Alijaj: Ne si Lëvizje Vetëvendosje shqetësimet tona për Stacionin Transfer i kemi paraqitur me herët ku kemi kërkuar nga Komuna qe te merr masat e nevojshme për ndaljen e djekejes se mbeturinave dhe kanë kaluar me shumë se tri javë për intervenim, ndaj te gjithë dimë se përgjegjës ligjor për këtë qeshte është Ndërmarrja Publike çabratit andaj kërkojmë sqarime dhe nëse është e nevojshme te vije ne mbledhjen e radhës edhe Krye shefi ekzekutiv i KRM çabratit dhe te na sqarime me detaishtë për këtë çështje .

znj. Dafina Sylja: Unë jam anëtare e Komitetit për Komunitete dhe e kemi diskutuar dhe ngritur shqetësimin tone për këtë deponi dhe djegieje e mbeturinave sepse pikërisht vendi ku ndodhet kjo depoi e mbeturinave është shumë afër me lagjen Kolonia ku jetojnë shumica e pjesëtareve te Komuniteteve pakicë, çfarë hapa do të ndermirën nga Komuna për Impiantin e riciklimit te mbeturinave .

z. Bekim Jupa: Unë jam anëtar i komisionit komunal te aksionareve për KRM çabratit dhe nga vitit 2015 kjo kompani nuk e menaxhon këtë stacion transfer andaj është shumë e nevojshme që në se bashku të

diskutojmë dhe te gjejmë një zgjidhje dhe ti ndihmojmë kësaj kopanise që Kuvendi i kominës ti merr përsipër pagesat dhe ti marrim te gjitha veprimet e nevojshme që të kemi një ambient të pastër dhe një kompani efikase .

Kryetari : Në fillim të vitit 2017 është hapur ankandi për menaxhimin e Qendrës Transfer dhe kushtet me të cilat është hapur aji ankand kanë qen shumë problematike për Komunën dhe për Ndërmarrjen Qabrat, sepse cabrati i paguan 6 euro për tonë në deponin e mbeturinave në Landovic. Ndërsa është menduar se fillimisht mbeturinat të shkojnë në qendrën transfer aty të riciklohet një pjesë dhe pastaj të barten nga Qabrati për ne landovic, dhe kur është llogaritur kostoja me gjithë qendrën transfer qabratit i ka dal 8 euro për ton pra ai rritet kostoja nga 6 në 8, dhe përkundër këtyre në ju kemi afruar kontratën por kompani nuk e ka nënshkruar e ka refuzuar atë kontratë. Zjarri aty behet qëllimshëm dhe kemi pasur mbi 20 her intervenime nga zjarrfikësit në të pjesë dhe në i kemi percjellur të gjitha letrat dhe dokumentet se bashku me të gjitha komunikimet në prokurori dhe tani as kush nuk ka kontratë për menaxhimi e saj , dhe se shpejti do tija japim me një kontratë një vjeçare kompanisë ton çabrati në menaxhim deri sa një të gjejmë një zgjidhje të qëndrueshme për këtë çështje . Ka pasur pengim të qëllimshëm për çabratin që mos të ketë mundësi me i pastru mbeturinat nga ajo deponi dhe zjarri është vënë qëllimisht në mënyrë që mos te ketë mundësi te qasjes deri tek mbeturinat që janë grumbulluar me vitet te tera , në kemi kërkuar ndihmë nga KFORI dhe FSK qe me mjetet e tyre speciale të mundësojnë qasje në mbeturinat që po djegën dhe të kemi mundësi me intervenimi që fillimisht të ndalet zjarri e pastaj ti fillojmë punën për largimin e tyre kostoja është deri në 500,000 euro. Këto probleme janë të akumuluar me vite dhe dikush kur e ka pa se këto probleme janë të vështira janë marre me ndonjë . Unë kam kërkuar nga Policia dhe nga Prokuroria qe te zhvillohen hetime për çështjen e zjarrvënës në deponin e mbeturinave .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur diskutimin për këtë pik te renit te ditës .

10. Pika e dhjet e rendit te ditës : Shqyrtimi i Deklaratës për adresimin e pabarazisë gjinore dhe veprimet që duhet të përmbushen në funksion të barazisë së plotë gjinore

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi kërkesën e Grupit të grave Asambleiste për shqyrtimin e Deklaratës për adresimin e pabarazisë gjinore dhe veprimet që duhet të përmbushen në funksion të barazisë së plotë gjinore, andaj e ftojme znj. Mimoza Shala që ta merr fjalën .

znj. Mimoza Shala: Deklaratën e hartuar ju kemi shpërndarë të gjithëve dhe shumicën e këtyre që janë të parapara Komuna e Gjakovës ka të themeluar por kërkohet që të themelohet komiteti për Barazi Gjinore .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime të tjera E qes në votim miratimin e Deklaratës për adresimin e pabarazisë gjinore dhe veprimet që duhet të përmbushen në funksion të barazisë së plotë gjinore. Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro kësaj** deklarate Pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë .

DEKLARATË

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës përmes këtij akti deklaron vullnetin dhe përkushtimin për tu angazhuar në vazhdimësi përmes adresimit në Institucionet përkatëse të dhunës në familje dhe parandalimin e sajë, në bazë të kompetencave që ka. Në Funksion të rritjes së vetëdijes së institucioneve dhe shoqërisë në përgjithësi mbi dhunën në familje, Kuvendi i Komunës së Gjakovës nxjerrë këto rekomandime :

1. Gjatë planifikimit të buxhetit të komunës të zbatohet në mënyrë më efektive mekanizmi për buxhetim të përgjithshëm gjinorë.
 2. Të miratohet plani gjinorë i veprimit dhe zyra për barazi gjinore të raportoj në Kuvendin e Komunës një herë në vite për punën dhe aktivitetet e kësaj zyre.
 3. Të rritet përkrahja për gratë në biznes dhe subvencionimi i iniciativave lokale të grave.
 4. Themelimi i komitetit për barazi gjinore dhe fuqizimi i mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje.
 5. Masat parandaluese dhe dënuuese ndaj gjuhës diskriminuese ndaj grave në institucionet lokale
 6. Të vazhdoj raportimi në baza vjetore pranë Kuvendit Komunal nga KKSBB (Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi), QPS (Qendra për Punë Sociale) dhe Komandantit të stacionit të Policisë lidhur me rastet e dhunës në familje dhe jashtë saj.
 7. Përkrahja financiare strehimores së viktimave të dhunës në familje dhe mbështetje për viktimat e dhunës.
 8. Identifikimi dhe përkrahja për nënat vetushqyese.
 9. Të organizohen aktivitetet të ngjashme si ajo "Java e Gruas" ose "Java kundër stigmës" në nivel lokal .
2. Obligohen organet e administratës Komunale, dhe institucionet tjera përgjegjëse që të marrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtyre rekomandimeve të cekura më lartë .

11. Pika e dhjetë e rendit të ditës : Të Ndryshme

Kryesuesi: E Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës a ka dikush ndonjë diskutim .

z. Zef Komoni: Unë dua të ndërlidhëm me mbledhjen e kaluar lidhur me pikën e Kullën Sylejman Vokshit sepse po flitet se disa asambleist kanë ndërruar qëndrimin e njeri nga tjetri edhe unë, fillimisht kam menduar se po vendoset për leje të ndërtimit por pasi që i kemi marrë sqarimet nga Kryetari se ne jemi duke vendosur vetëm për çështjen e eksproprijimit tani kam vendosur për me e përkrah, na kanë quajtur atentator , antikulturor, ata persona që na kanë quajtur ashtu unë po ju them se Kultura duhet të ketë kontinuitet, po ju them se ndër njerëzit me të kulturuarit ka qenë Aton Qeta dhe pse komuna e Gjakovës i ka ndarë mjetet që 13 vite për ngritjen e shtatores ende as kush i kulturuar nuk e ka ngritur këtë çështje . Le të qelën dokumentet e të shikohet se kush ka qenë bashkëluftëtar i Sylejman Vokshit , jam shumë i sigurt se askush nuk ka qenë me mbiemrin Qarkagja por jam shumë i sigurt se kanë qenë 12 me mbiemrin Komani andaj nuk është ne rregull me na quajt anti kulturor dhe antihistorik pra kërkoj që të kemi kujdes për deklaratimet publike .

Kryetari: Eksproprijimi nuk është bërë për me e mbrojt Kullën e Sylejman Vokshit, dha as de eksproprijimi nuk është bërë për me e dëmtuar Kullën e Sylejman Vokshit por krejt kjo propaganda është bërë prej interesave meskinë të dikujt, pra ne kemi marrë vendim për me e largu prej eksproprijimit në mënyrë që të ruhet buxheti i Komunës . Nuk ka nevojë kurrkush me më tregu se duhet me e ruajt Kullën ose me më shit mua patriotizëm, Ministria nuk mundet me na detyruar ne si komuna që me eksproprijim tokë sepse nuk kanë të drejtë , ata mundin me na dërguar një letër që nuk kemi të drejtë me ndërtuar në afërsi prej 50 metrave por jo me na detyruar me ble tokë nëse ne nuk dojmë.

znj. Dafina Sylja: Kemi një kërkesë nga Komiteti për komunitete ku e kanë dorëzuar një kërkesë në zyrën e Kryesuesit me dt. 18. Mars ku komuniteti Rom ka paraqitur një kërkesë lidhur me ditën ndërkombëtare të tyre që është 8 Prilli dhe kanë kërkuar që një rrugë në qytetin e Gjakovës të emërtohet 8 Prilli sepse po ne këtë datë është vendosur për simbolin e tyre ne Flamur dhe për Himnin e tyre Kombëtar andaj kërkoj nga Kryesuesi që të shqyrtoj me seriozitet këtë kërkesë .

z. Muharrem Musa : Kërkoj nga të gjithë Koleget që mos të bien pre e telefonatave dhe e interesave të tyre të ngushta e të shkaktojnë përçarje dhe ofendime ne mes veti këtu ne kuvend . Kemi një donator që ka ofruar mbështetjen për ndërtimin e 22 shtëpive për komunitetet në Komune e Gjakovës por jemi duke i kompletuar dokumentet ku në fshatin Netic janë disa familje që do të ju ndërtohen shtëpitë por ende nuk i kemi plotësuar ato dokumente .

Ne fshatin Bardhaniq kur është nderuar Rruga Bardhaniq Dashnor është dëmtuar një urë dhe aty është drejtuar kanali i ujerave amosferike ne drejtim te shtëpive dhe ata tani po vershohen nga ujerat andaj kërkojmë qe të intervenohet sa me parë .

znj. Lirika Komani: Meqenëse muaji Mars është muaj i Gruas ne kemi dy kërkesa që kërkojmë që të përkrahen nga te gjithë ju fillimisht besojmë se të gjithë e keni dëgjuar historinë e qikave te familjes Bejtullahu të cilat e kanë humbur jetën se bashku me të atin duke u përpjekur që të mbrohen nga përdhunimet andaj kjo ngjarje ka në thelb karakter kombëtar, por me kalimin e viteve vendi ku ka ndodhur ngjarja se bashku me varret e tyre njihet si tyrbja e qikave, andaj në mënyrë që të ruhet historia kërkojmë që të ndërtohet rruga deri tek këto varre dhe të ndërtohet një krua dhe të vendosen disa stola dhe kërkojmë që të vendoset një pllakë përkujtimore në këtë shtëpi . Se dyti është historia e Nenës Pashke Markaj e cila i vuri flaken vetes tri ditë pasi që i ka rivarrosur djemtë e saj të vrarë në luftën e fundit, andaj kërkojmë që ta emërtojmë një rrugë me emërin e saj .

z. Shanban Luma: E falënderoj DKRS-në për investimet që po ndodhin tani në Pallatin e Kulturës në Fshatin Cermjan , pyetja ime është se a po mbikëqyren ato punime se a janë duke ndodhur sipas kontratës dhe pasoi që po behën të gjitha ato investime a e keni paraparë mundësin e punësimit të ndonjë punëtori ato në mënyrë që të mirëmbahet aji objekt . Për Drejtorin e Shërbimeve Publike kemi kërkesë nga banorë e fshatit Gergoc të cilëve i është prishur ndriçimi Publik kërkojnë nga drejtoria për shërbime publike që të intervenoj ne sanimin dhe rregullimin e rrjetit të ndriçimit Publik . Gjithashtu kërkesa tjetër është nga Banoret e Fshatit Kralan që të bëhet përmirësimi dhe rregullimi i gropave që janë shkaktuar në rrugën e këtij fshati.

znj. Mimoza Shala : Kemi një reagim nga Komitetit për arsim i VV, gjatë këtyre ditëve kemi përcjell me shqetësim aktivitetet që po zhvillohen në Komunën e Gjakovës dha ajo që po vërehet është inati i DKA-s dhe i MASHT-it ndaj mësimdhënësve që nuk po i vijon mësimet për plotësimin e orëve të humbura gjatë Greves, gjithashtu është duke u shkelur e drejta e fëmijëve për te pushuar qe është e garantuar me ligj ndërsa në të njëjtën kohe nuk i garantohet mësim cilësor gjatë orëve të rregullta. Duhet të ceket se neper disa shkolla kanë filluar te mbahen orë Fantazmë pa nxënës dhe ideja për me i shenu orët si te mbajtur edhe pa nxënës ose me shumë pak nxënës në klasë kjo është cilësia e mbarëvajtjes sipas DKA-së gjithashtu DKA kërkon nga drejtoret që të raportojnë se cilët mësimdhënës ishin në shkollimet jo që ka për qëllim me i identifikuar se cilët mësimdhënës po respekton vendimin e sindikatës . Kjo është shumë e çuditshme sepse kjo po na kthen në vitet e 90 kur numëroheshin nxënësit dhe mësimdhënësit shqiptar me qëllim që të rriheshin apo e burgoseshin ndërsa sot këto behën me qëllim e këta mësimdhënës mos të përkrahen nga DKA-ja . Ne si Komitet i Arsimit të VV jemi kundër humbjes se orëve të mësimi por jemi edhe kundër që mësimdhënësit të kërcënohen dhe të zhantazhohen direkt ose indirekt nga punëdhënësi dhe jemi kundër që fëmijëve të ju shkelet e drejta .

Kryesuesi: Kjo çështje është në interes për të gjithë ne sepse jemi prindër dhe po del në pah se edhe atëherë në grevë edhe sot sindikata paska qenë e politizuar sepse i paska njerëzit dhe po del se edhe politika i paska duart këtu, këtu nuk ka as një faj DKA-ja andaj ne duhet te jemi të gjithë unik që të plotësohen orët e humbura sepse nuk munden te humbin orët e të mbesim prapa ne arsim nxënësit në shkollat e komunës sonë

znj. Mimoza Shala: Edhe reagim jon përafërsisht e tha këtë që po e thoni ju z. Kryesuese që jemi kundër me i humb orët e mësimi por jemi kundër që dikush me i shënuar kinse janë mbajtur orët e mësimi pa u mbajtur.

z. Bernard Frrokaj: Ajo që u lexua nga zonja e nderuar po ngjason si reagim i sindikatës e jo i një komiteti për arsim sepse komitetet e tilla duhet të kontribuojnë për me i edukuar brezat e jo me i nxjerr ne rrugë. Sindikata është dakorduar me e ndërprerë grevën ndërsa nga MASHT-i ka ardh një vendim që ne me kërkua nga mësimdhënësit që me dal në mësim dhe nëse na vije ndonjë shkresë nga MASHT-i me dal në mësim në duhet me bërë thirrje me dal në mësim sepse ne për këtë paguhemi dhe e kemi obligim. Sa i përket kërcënimeve është turp për ata që e kanë shënuar atë shkrim ndërsa pe rraporet e punëve të gjithë drejtorët e shkollave duhet ti sjellin raporte të punës edhe unë si drejtor i DKA-s i prezantoj Raportet e punës sepse e kam obligim. Nuk është bërë as një ndëshkim që u tha nga ju dhe nëse ka ndonjë të dhen që është shënuar ora pa u mbajtur atëherë na njoftoni sepse ne nuk kemi njohur të tilla.

z. Edmond Dushi : Dua ta ngris një shqetësim për drejtorin e Shërbimeve Publike që ka të bëjë me shtyllat e ndriçimit publik ku kanë qenë të vendosura dekorimet e qytetit gjatë festave të fund vitit kur janë larguar ato kanë mbetur telat e zhveshur dhe kapakët e qelur andaj kërkojmë që të urdhërohet kompania apo kush është përgjegjës që të sigurohen këta tela dhe të mbyllen ato kapaka sepse paraqesin rrezik për qytetarët

z. Kreshnik Alijaj: Një shqetësim drejtuar Drejtorisë së inspektorati lidhur me tregun e druve pavarësisht se është publikuar në Faqen e Komunës vendimi se tregu është siguruar dhe është transferuar në vend të caktuar aty afër Stacionit të Autobusëve prapa vazhdon shitja e druve dhe qytetarët janë të shqetësuar andaj pse nuk po zbatohet ai vendim.

z. Sadik Hoti: Ne fillim sa i përket orëve të humbura duhet të mbahen, kërkojmë përgjigjeje nga drejtori i Arsimit dhe i financave pse nuk paguhen 3 pagat pas pensionimit por detyrohemi ne që përmes përmbaruesve dhe formave tjera i nxjerrim ato paga .

znj. Florentina Gjergjaj: Sa i përket arsimit si mësimdhënëse dhe si prind obligona që ti them zonjës që ai komitet që ka hartuar kësi raporti që tërheq paralele me vitet e 90 mua si prind por edhe si mësimdhënëse nuk me duket e hijshme dhe nuk korespondon me këtë kohë por është një krahasim joreal , ju e thatë se jemi por atyre dhe pro këtyre andaj na jep solucionin se si të veprojmë ne sipas jush .

znj. Mimosa Shala: Secili prej nesh e din se si funksionojmë ne si shoqëri, paralelja që është tërhequr për mu është me e rend nëse ndodh ndonjë kërcënim sot se sa vitet e 90-ta .


z. Durim Halilaj: Nga ky vit pagat jubilarë janë të buxhetuara por problemi është tek ato që nuk kanë qen të buxhetuara pra nga ky vit janë të siguruar dhe do ti marrin menjëherë të gjitha ta që ju takojnë ato paga .

z. Bekim Jupa : E përgëzoj znj. Komani që e ngriti iniciativën për emirin e një rruge apo sheshi me emrin e Nenës Pashke ne si PDK e përkrahim, andaj kërkojmë që kjo krekës të jetësohet .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur këtë mbledhje dhe mirë u pafshim në takimet e radhës .


Mbledhja u shpall e mbyllur në ora 14:00.

Procesmbajtës


Burim Bajrami



Kryesuesi i Kuvendit


Z. Anton Shala